



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 18106 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 72, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR
OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN TEKNIKE ELEKTRIKE
“GJERGJ CANCO” TIRANË

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”,

VENDOSI:

1. Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Teknike Elektrike “Gjergj Canco” Tiranë, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 6, datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, **Akreditim me kusht**, me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023,
2. Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas vendimit nr. 6, datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për kualifikimet profesionale si më poshtë:
 1. “Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit” Niveli II në KSHK, T-II-20
 2. “Rrjete të dhënash” Niveli IV në KSHK, T1-IV-21
 3. “Mbështetje e Përdoruesve të TIK-ut” Niveli IV në KSHK, T2-IV-21
 4. “Zhvillim Website” Niveli IV në KSHK, T3-IV-20
 5. “Programim” Niveli IV në KSHK, T5-IV-21

6. "Multimedia" Niveli IV në KSHK, T6-IV-21
7. "Elektroteknikë" Niveli II në KSHK, E-II-20
8. "Instalime elektrike civile dhe industriale" Niveli III në KSHK, E1-III-20
9. "Instalime dhe mirëmbajtje të linjave TU dhe TL" Niveli III në KSHK, E2-III-20
10. "Elektromekanikë" Niveli III në KSHK, E4-III-20
11. "Riparim i pajisjeve elektronike" Niveli IV në KSHK E6-IV-20
12. "Telekomunikacion" Niveli IV në KSHK, E7-IV-21
13. "Elektroteknikë" Niveli IV në KSHK, E-IV-21

3. Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1; shkronja a) e nenit 18, nr.128 datë 6.7.2021, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë " Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Teknike Elektrike "Gjergj Canco" Tiranë, do t'i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ervin METE

